

## TOPONIMET E DYFISHTË SI SHKAS I MOSKUPTIMEVE NDËRSHTETËRORE NË BOTËN E GLOBALIZUAR

### DOUBLE TOPONYMS AS REASON FOR INTERSTATE MISUNDERSTANDINGS IN THE GLOBALIZED WORLD

**MUSTAFA IBRAHIMI**

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit; Universiteti i Evropës Juglindore  
Illindenska p.n., Tetovë - MAQEDONIA  
Email-i : m.ibrahimi@seeu.edu.mk

#### **Përmbledhje**

Në shumë shtete jo vetëm njerëzit por edhe shtetet, qytetet, rajonet dhe territore të caktuara ndryshojnë emrat. Këto ndryshime të emrave ndodhin për shumë raste. Mund të ndodhin për shkak të ndërrimit të **sunduesve, pikëpamjeve ideologjike, pikëpamjeve historike, si dhe pikëpamjeve gjuhësore**. Riemërtimet e tilla nuk kanë të bëjnë vetëm me ndryshimin e shenjës, por në një mënyrë simbolike kanë rëndësi të veçantë edhe për jetën e një populli. Nga dëshira e madhe për t'u kthyer në emërtimet origjinale, shpeshherë ndryshimi i emrit të shtetit, qytetit, rajonit apo ndonjë territori të caktuar sjellin konfuzione ndërkombëtare dhe ndonjëherë ndikojnë drejtpërdrejt në lindjen e problemeve ndërkombëtare. P.sh. vallë kryeqyteti kinez quhet Peking apo Beizhing, siç e emërtojnë kinezët, ose shembulli me qytetin indian Bombaj që tani emërtohet Mumbai, paraqesin probleme në komunikimin ndërkombëtar, sepse edhe Organizata Botërore di të gaboj. Një situatë e tillë mbretëron edhe në Ballkan. Një kohë shumë të gjatë në Maqedoni, emrat bineq si: Skopje – Shkup, Kiçevo – Kërçovë, Debar - Dibër shiheshin si të rrezikshme dhe përjetohen si “albanizim” i toponimeve. Në botë është paralajmëruar se do përgatiten doracakë me të cilët bota e globalizuar të gjendet në situata kur ndryshimet e tilla, sidomos në Afrikë por edhe në nënkontinentin indian janë shumë të shpeshta.

**Fjalët çelës:** gjuha, toponime, identiteti, globalizimi  
**Hyrje**

Për ta kuptuar perspektivën e gjuhës, mjaft të rëndësishme janë dukuritë onomastike, sepse toponimet janë pjesë përbërëse e trashëgimisë historike – kulturore. Gjatë gjithë shek.XIX, përveç gjuhësisë, shpjegimi i toponimeve ishte mbështetje e

sigurt për studimet historike të epokave më të hershme. Për një kohë shumë të shkurtër onomastika do të zë një vend të rëndësishëm në gjuhësi, duke u renditur si disiplinë e veçantë. Shumë emërtime të atij kuptimi nuk paraqesin prejardhjen autoktone, por situatë aloglote, gjegjësisht marrja e etnonimit sipas ndonjë dukurie.

Në shumë shtete jo vetëm njerëzit por edhe shtetet, qytetet, rajonet dhe territore të caktuara ndryshojnë emrat . Emrat e dyfishtë janë dukuri e përgjithshme të gjeografisë njerëzore. Bota në përgjithësi, Evropa e në veçanti Ballkani, që ka një histori të gjatë, janë aq të ngarkuar sa që paraqesin problem ndërkombëtar. Andaj emërtimi i vendeve, por edhe i popujve paraqet problem të veçantë.

Këto konfuzione ndërkombëtare lindin nga dëshira e madhe për t'u kthyer në emërtimet origjinale, të emrit të shtetit, qytetit, rajonit apo ndonjë territori të caktuar. Ndonjëherë këto riemërtime ndikojnë drejtpërdrejt në lindjen e problemeve ndërkombëtare. P.sh. vallë kryeqyteti kinez quhet Peking apo Beizhing, siç e emërtojnë kinezët, ose shembulli me qytetin indian Bombaj që tani emërtohet Mumbai, paraqesin probleme në komunikimin ndërkombëtar, sepse edhe Organizata Botërore di të gaboj. Jo rastësisht është paralajmëruar se në botë do të përgatiten doracakë me të cilët bota e globalizuar të gjendet në situata kur ndryshimet e tilla, sidomos në Afrikë por edhe në nënkontinentin indian janë shumë të shpeshta.

#### **1. Faktorët që ndikojnë në ndryshimin e emrave**

Ndryshimet e emrave ndodhin për shumë raste. Mund të ndodhin për shkak të ndërrimit të **sunduesve, pikëpamjeve ideologjike, pikëpamjeve historike, si dhe pikëpamjeve gjuhësore**. Riemërtimet e tilla nuk kanë të bëjnë vetëm me ndryshimin e shenjës, por në

një mënyrë simbolike kanë rëndësi të veçantë edhe për jetën e një populli. Nga dëshira e madhe për t'u kthyer në emërtimet originale, shpeshherë ndryshimi i emrit të shtetit, qytetit, rajonit apo ndonjë territori të caktuar sjellin konfuzione ndërkombëtare dhe ndonjëherë ndikojnë drejtpërdrejt në lindjen e problemeve ndërkombëtare

### 1.1. Ndërrimi i sunduesve dhe lindja e toponimeve shumëgjuhësore

Një çështje me interes për të dëshmuar mbijetesën dhe qëndresën e popujve të sunduar ndaj asimilimit nga pushtuesi është prania e emërtimeve të dyfishtë apo dygjuhësore. Këto emërtime kanë lindur si rezultat i trysnisë asimiluese nga sunduesit e caktuar.

Sipas ndërrimit të sunduesve: **Raguza** së pari ishte i nënshtruar nga Bizanti, por nga fundi i Luftës së Parë Botërore, ai është **Dubrovniku** kroat. Qyteti **Fiuma** (lum) ishte qytet italian, pas vitit 1947 i jepet Kroacisë dhe quhet **Rijeka** (lum), d.m.th. këtu është ruajtur kuptimi i njëjtë, pra lumë. **Viena** guri i çmuar i Austrisë në shek. 9 u mor nga Hungaria dhe u emërua **Beç** (kështu edhe sot e kësaj dite e emërojnë serbët e kroatët), kurse sllovakët e quajnë **Dunaj**. Mjaft interesant është qyteti ukrainas **Lviv**, i cili në shekullin e14-të u mor nga polonezët dhe u emërtua **L'vov**. Më 1772 qyteti iu bashkëngjiti austriakëve të cilët ia dhënë emrin **Lemberg**, të cilin rusët do ta marrin më 1914, por do ta humbin një vit më vonë; Qyteti baltik **Memell** nga Gjermania është ndarë më 1919, ndërsa nën okupimin lituan ra më 1923 kur edhe e mori emrin **Klajpeda**; Qyteti slovak **Bratislava**, i cili një kohë të gjatë ishte qytet hungarez me emrin **Poszoni**, për gjermanofonët ai është **Presburg**.

Raste të tilla ndeshim në emërtimet e qyteteve dhe toponimeve tjera në mbarë botën, si: Lubjanën e Slovenisë, gjermanët e quajnë **Lajbah**. Limani baltik, jo shumë larg Sankt-Peterburgut ekziston emërtimi i dyfishtë **Brasov** (rusisht) / **Kronstadt** (gjermanisht); Në Banat, në rumanisht kemi **Timisoara**, kurse në hungarisht **Temishvar**; **Breslau** (nga gjermanët) / **Vroclav** (nga polonezët); **Kenigsberg** (nga gjermanët) / **Kaliningrad** (nga rusët); Qyteti finlandez **Turku** gjithashtu e mban emrin suedez **Abo** (A`e`, 1997: 135-136).

Nuk janë të rralla rastet kur për të njëjtin vend popuj të ndryshëm përdorin emërtime të ndryshme, si p.sh.: **Gjeneva** e Zvicrës në frëngjisht quhet **Zhëneve**, në gjermanisht **Genf**, në italishte **Xhinevr**; **Gjenovën** e Italisë francezët e quajnë **Zhenë**, gjermanët **Genua**, ndërsa vetë italianët **Xhenova**. Moskën vetë rusët e quajnë **Moskva**, francezët **Moskú**, gjermanët **Moskau**. Në Transilvani, shumica e qyteteve kanë emra të dyfishtë, njëri romun dhe tjetri gjerman, e disave u

shtohet edhe emri hungarez: P.sh.: **Cluj-Napoca** (rumanisht) / **Kolloshvar** (hungarisht) / **Klauzenburg** (gjermanisht); **Sighisoara** (rumanisht) / **Segesvar** (hungarisht) / **Schassburg** (gjermanisht); **Sibiu** (rumanisht) / **Hermanstadt** (gjermanisht) / **Nagyszeben** (hungarisht); Veriperëndimi i Rumanisë është arketip, i shteteve të Evropës së Mesme ku popujt e afërt me shekuj grindeshin, duke menduar se kanë të drejtë mbi një territor të caktuar. Bëhet fjalë për **Transilvaninë** ose **Ardealin** (siç quhet nga rumunët), **Erdel** nga hungarezët, **Ziberburgen** nga gjermanët. Emërtime të tilla kemi edhe në Kosovë e Maqedoni: **Pejë** (shqip) / **Ipek** (turqisht) / **Peç** (serbisht); **Mali i Zi** (shqip) / **Karadak** (turqisht) / **Crna Gora** (sllavisht); **Selanik** (shqip) / **Tesaloniki** (greqisht) / **Sollun** (sllavisht); **Korfuz** (në shqip) / **Qerqira** (në greqishte) / **Krf** (në Maqedonisht); etj.

Nuk është rëndë të gjenden shembuj të tillë në Ballkan, Evropë dhe botë. Emrat e tyre të dyfishtë tregojnë fatet e tyre të ndryshueshëm gjatë historisë nëpërmjet onomastikës.

### 2.1. Sipas pikëpamjeve ideologjike

Sipas ngjyimit ideologjik zakonisht përcaktohen për një formë të "pastër" leksikore sesa për një huazim. Karakteristike e këtij faktori është se si përpos pushtetit, i cili në mënyrën e tij e merr të drejtën të jep emra, përzihet edhe ideologjia, të cilët me anë të krijimit të fjalëve të reja qojnë drejt nacionalizmit, ndërsa në raste tjera në konflikte fetare, p.sh. hindët për neologjizmat e tyre huazojnë fjalë nga sanskritishtja, kurse urdu huazojnë nga arabishtja ose persishtja, siç ndodh edhe me gjuhën boshnjake.

Në këtë drejtim më karakteristik janë veprimet e ish-shteteve socialiste të cilët ca toponimeve u ngjitnin (ripagëzonin) emra të personaliteteve të jetës politike e shkencore, me ç'rast u krijuan toponimet ideologjike. P.sh. Në Rusi për nder të meritave të Leninit në Revolucionin e Tetorit, disa vendbanimeve të vogla u riemëruan me emrin e tij, si: **Lenjino**, **Lenjinsk**, **Leninakan** etj. Me emrin e Leninit u pagëzua edhe **Sankt-Petersburgu** si **Leningrad** e shumë të tjerë. Me ndryshimin e toponimeve vazhdoi edhe në kohën e Stalinit. Një vend nderi Stalini i dha vetes që nga viti 1925, me çka riemëroi disa qytete me emrin e tij, si qytetet **Caricin** dhe **Volgograd** të cilët u pagëzuan me emrin e tij si **Stalingrad**. Më vonë të dy qyteteve iu kthyen emrat e mëparshme.

Këtë fat e ndoqi edhe shumë qytete në Gjermaninë Lindore, si qyteti gjerman **Henmic**, i cili pas vitit 1945 u riemërua në **Karl Marks shtat** duke e mbajtur pesë dekada. Në vitin 1990, me një referendum popullor iu ktheu po ashtu emri i mëparshëm.

Edhe në Shqipëri, për hir të idhullit të vet – Stalinit, Enver Hoxha më 19.12.1950, vendosi që qytetit të Kuçovës t'i jap emrin e tij **Qyteti Stalin**. Kjo zgjati deri në vitin 21.12.1990 kur u vendos emri i Stalinit të hiqet nga çdo vend publik. Po qyteti i Kuçovës u rehabilitua ka fundi i shkurtit të vitit 1991.

Toponimia ideologjike dhe kulti i personalitetit ishte më i pranishëm në ish-Jugosllavi, ku u vendos që ca vendbanime të riemërohen me emrin e Titos. Gjithsej 8 qytete u riemëruan me emrin e tij në tërë vendin, d.m.th. nga një qytet në secilën njësi federale, si: **Titograd, Titovo Velenje, Mitrovica e Titos, Tito Veles, Titovo Uzhice, Titov Vërbas etj..** Të gjithë këto emra ideologjike, pas ndryshimeve të mëdha dhe shpërbërjes së ish-Jugosllavisë u kthyen emrat e mëparshme.

Ndërrimi i toponimeve mund të bëhet edhe për shkak të ndikimit të ndonjë gjuhe tjetër ose nga ndikimi perëndimor, kolonial, gjuhës zyrtare. Në shumë shtete që janë të kolonizuara, pushteti kolonial të gjithë emërvendet i ka emërtuar sipas dëshirës së tyre, ose ideologjisë kolonizuese. Nga ana tjetër pushteti nacional të cilët ku më pak e ku më shumë mbështeten në traditën ose në ideologjinë nacionaliste, këtyre tendencave u kanë bërë ballë me emërtimet lokale. Shumë shtete pas fitimit të pavarësisë e kanë ndryshuar emrin duke i kthyer emrat lokale, si p.sh.: **Kongoja Belgjike** bëhet **Zair**, **Dahomej** bëhet **Benin**, **Volta e Epërme** bëhet **Burkina Faso**, **Gijana Holandeze** bëhet **Surinam** etj. I madh është edhe numri i qyteteve të ciltë janë pagëzuar ashtu: **Leopoldvil** dhe **Elizabetvil** në Zair bëhen **Kinshasa** dhe **Lubumbashi, Mazagan** dhe **Por-Liote** në Maroko bëhet **El Xhadida** dhe **Kenitra** etj. (Kalve 1995:274). **Kazablanka** nga arabët quhet **Dar el Beida**; **Ferivil** u bë **Mancel Burgiba** (Kalve, 1981: 131).

Shpesh herë në botë këto ndryshime që ndodhin, mund të bëhen edhe për shkaqe tjera të ndryshme, p.sh. kur kryeqendra japoneze vendosi ta ndërroj emrin e lashtë **Yeddo** në **Tokio** “*rezidenca lindore*” në këtë mënyrë u paralajmërua një epokë të re në historinë japoneze. Në këtë mënyrë vepruan edhe shumë kryeqendra tjera dhe gjithkund këtij veprimi i jepnin rëndësi të veçantë, p.sh. **Shën Petersburgu**, së pari u bë **Petrograd** e pastaj **Leningrad**, **Kristiana** u bë **Oslo** etj. (Jespersen 1970:150).

### 3.1. Pikëpamjet historike

Shpesh herë, emërtimet e vendeve nuk kanë lidhje me gjuhën e një grupi etnik. Toponimi është supstrat i cili më së tepërmi u kundërshtohet shtresave gjuhësore të cilët ndryshohen, ose njëri – tjetri “ngulfaten” në disa vende të rruzullit tokësor. Këtu është e dukshme gjurma e gjuhëve të zhdukura, me vetë këtë edhe

glotofagia: Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku indianët janë zhdukur, por emërtimet e vendeve shpesh herë janë indiane: **Masaqsets, Minesota, Misisipi, Misuri, Oregon** etj. Në gjuhën angleze ka shumë pak fjalë kelte, por janë ruajtur mirë në emërtimin e vendeve: **Kent, Devon, Kamber(land), Dover, London, Jork, Evon, Esk, Temza, Uaj, Lidz, Glo(çester), Eks(eter), Vin(çester), Sali(beri)**, etj. (Mossé, 29). E njëjta gjë është edhe me fjalët gale, të cilët në gjuhën franceze janë të pakta, por në toponominë franceze janë të shumta. Qe disa shembuj: emra lumenjsh: (**Rajna, Sena, Marna, Soma, Meza..**) (Kalve, 1981, 132).

Nuk është i vogël edhe substrati ilir në Ballkan. Ky supstrat më së tepërmi mund të shihet në oronimi, ku shihet diferencimi paraslloven substrope. Ky ndikim ilir, më së tepërmi shihet te apelativi **\*mal** : **Malezi** , **Mal të Zi, Malesh, Malen, Malovan** etj. (Pavloviq, 144), por edhe në emrat : **Dalmaci, Dardani, Dimalum, Ulqin, Vendum, Vis, Budva, Dukla, Tara, Zara, Butrinti, Theranda, Shkupi, Shtipi, Sharri, Shkodra, Nishi** etj. Deri më tani në Shqipëri, ekziston vetëm një toponim që mban emrin e një personaliteti të historisë sonë kombëtare. Është ky **Bajram Curri**, emër që i është dhënë vendbanimit **Kolgeci**, në rrethin e Tropojës.

#### 4.1. Pikëpamjet gjuhësore

Ashtu si në çdo gjuhë, në rrjedhë të shekujve kanë pësuar edhe ndryshime, disa kanë mbetur por janë ndërruar fonetikisht.

Trajtat e sotme të toponimeve shqiptare dhe të leksikut të kësaj gjuhe përgjithësisht, janë formuar dhe zhvilluar në rrymë të kohëve nëpër shkallë të një evolucioni të brendshëm e të jashtëm sipas ligjeve fonetike, morfologjike, fjalëformuese e sintaksore vetjake të kësaj gjuhe, e jo sipas ligjeve e dekretive administrative shtetërore të dikujt. Për ta përligjur këtë po marrim disa shembuj:

Nëpërmjet krahasimit të formave të moçme të toponimeve të tilla me të sotmet, mund të shihet se ato kanë pësuar evolucionin e natyrshëm sipas ligjeve fonetike të shqipes, njësoj si fjalë të tjera vendase, si p.sh. kalimi i s në **sh**, si p.sh.: **Shkodra (<Scodra)**, Scupi > Shkup, Lissus > Lesh>Lezhë, isoja > ishull etj.. Por edhe ndryshime tjera: **Vlora (<Aulon)**, **Ulqini (<Ulkinion)**, **Durrësi (<Durrachium)**, **Pojani (<Apollonia)**, **Shurdha (<Sarda)**, **Artë (<Arachtos)**, **Shkupi (<Scupi)** (Shkurtaj, 2001: 29), mund të futet këtu edhe **Dhërmi (<Germinium)** (Mansaku, 1982: 105).

Sipas R. Ismajlit toponimet e lashta (antike) u ruajtën kryesisht emërtime të pazbërthyeshme ose të zbërthyeshme me vështirësi, kurse emërtime të tjera të vjetra, por kuptimisht të zbërthyeshme u përkthyen

dhe u përshtatën sipas gjuhës së etnikumit sundues (Ismajli, 1978: 152-153).

Nëse marrim si shembull emrin e qytetit antik të **Shkupit**, i cili në gjuhë të ndryshme del me forma të ndryshme, do të vërejmë se te të gjitha gjuhët ky toponim pëson ndryshime në pajtim me fonetikën ose me treaditën e përdorimit të gjuhëve të ndryshme, p.sh.: **Shkup** (në shqip) / **Skopoi** (më greqisht) / **Uskup** (në turqisht) / **Skopje** (maq.) / **Skoplje** (serb.). Ajo që është këtu e rëndësishme është fakti se vetëm shqiptarët kanë ruajtur emrin e vjetër të qytetit të **Shkupit**, pikërisht sipas ligjeve të gjuhës së tyre. Emërtimi **Shkup**, tingull për tingull mbulohet me formën latino-dardane **Scupis** dhe kurrsesi nuk mbështetet formën sllave ose turke. Nga ana tjetër, ky emër ka pësuar ndryshime sipas zhvillimit të brendshëm të ligjeve fonetike të shqipes, dhe asnjë pushtet qoftë ai turk, grek e ndonjë tjetër nuk ka mundur të diktojë përdorimin e një forme të vetme vetjake; Ta marrim si shembull edhe toponimin tjetër **Manastir**, siç quhet nga shqiptarët qyteti i konzujeve në Pelagoni, në lindje të malit Pelister, i njohur te popullsia sllave të jugut me emrin **Bitolla** (te maqedonasit), **Bitolj** (te serbët) etj. Emri i këtij qyteti që rron edhe te turqit me formën **Monastir**, është formuar nga termi krishter i greqishtes **monastirion**, një ballkanizëm që ka depërtuar edhe në vetë gjuhët sllave, khs. Sllavishten e vjetër **monastyrz**, bul. **Manastir**, serbisht **manastir**, maq. **Manastir** me një varg rrjedhojash në këtë gjuhë si **manastiriste** “vendi ku ka pasur manastire), **manastirski**, **manastirce** etj. Ky emër më vonë sllavizohet në **obiteljz**, ku prej këndeje formohen edhe **Bitolj**, **Bitola**, cinc. **Bitule** (Skok, I: 454), ndërsa në shqipen dhe turqishten rruhen format e kryehershme, **Manastir** dhe **Monastir**. Ky toponim rruhet edhe në maqedonishten dhe serbishte në toponime dhe mikrotoponime tjera, si: **Manastiriste**, **Manastirce** etj.

Disa nga toponimet e një gjuhe nuk mund të shkruhen dhe nuk mund të shqiptohen me grafemat dhe fonemat e gjuhës tjetër. Meqë shqipja ka 5 shkronja më shumë se maqedonishtja (ë, y, th, dh, rr) dhe normal se këto shkronja i takojmë edhe në toponimet shqiptare si në Shqipëri, Kosovë por edhe këtu në Maqedoni, paraqiten ndryshime në emërtimin e tyre si p.sh. : maqedonasit nuk kanë mundësi t’i shkruajnë dhe shqiptojnë drejt në variantin e shqipes toponimet: **Durrës**, **Qafa e Thanës**, **Malësia e Madhe**, **Shkodra**, **Bytyçi** etj., por i përdorin me modifikime si: **Draç**, **Qafasan**, **Golema Malesija**, **Skadar**, **Bitiç** etj. Edhe pse janë bërë ndryshime kjo punë është fare në rregull dhe nuk e pengon as shqipen as maqedonishten, dhe as që ka të drejtë dikush t’i thotë maqedonasit pse vepron

kështu? Por shtrohet pyetja, prej nga tash maqedonasi të drejtë, se si duhet t’i përdor shqiptari toponimet, edhe atë në gjuhën e tij!

Një tjetër problem thelbësor rreth toponimeve origjinale është i lidhur ngushtë me natyrën e gjuhës dhe rregullat e saj fonetike, morfologjike e sintaksore. Nëse nuk respektohen rregullat gjuhësore, gjatë shquarsisë, rasave të emrave, formimit të mbiemrave dhe ndajfoljeve etj., do të kemi një kaos dhe një kakofoni ndaj të cilëve do të kishte alergji çdo shqiptar.

## 2. Pasojat e nacionalizmit linguistik

Si gjithkund edhe në toponiminë shqiptare mund të shihen pasojat e nacionalizmit linguistik si rezultat i tendencave të caktuara politike. Pushtuesit e Shqipërisë me ndërrimin e emrit kanë pasur fare të lehtë që ta përjetësonin pushtimin e tyre. Prandaj gjatë gjithë historisë shqiptare ka pasur riemërtime të vendbanimeve. Nga studimet e deritashme, *mund të thuhet se ojkonimet janë pjesa që i është shtruar më tepër trysninë së huaj. Aty, më tepër se kudo tjetër në onomastikë, kanë vepruar administrata e pushtuesve të ndryshëm, të cilët kur kanë mundur kanë bërë përkthimin e oikonimeve në gjuhën e ardhësve, duke fiksuar kështu në shkrime më shumë emra të huaj sesa do të ketë pasur realisht nëpër trojet shqiptare.* Për këtë ndikuar kuptueshmëria dhe përthyeshmëria e toponimisë shqiptar, që jepte rast edhe për një farë dygjuhësie popullore, e nga kjo u favorizua përhapja e mbizotërimit i toponimisë sllave. (Shkurtaj, 2001:29).

Është fakt se në **Shqipëri** më shumë janë prekur oikonimet, duke mbetur në trevat tona gjurmë të qarta të toponimisë sllave, siç janë: *Zagora* (Mbishkodër), *Zagoria* (Gjirokastër), *Zagorçani* (Pogradec), *Pogradec*, *Zadrimea*, *Çorovoda*, *Kozara*, *Podgora* etj. Por vëmë re se gjithandej në hapësirat shqiptare, pranë toponimisë së huaj (kryesisht ojkonime) në trungun e moçëm shqiptarë kanë mbijetuar toponime paralele shqipe. Prandaj me të drejtë Kostallari e ka kritikuar Selishçevin që në librin e tij “Sllavjanskoe naselenie u Albanii” nuk ka marrë parasysh në mënyrë të mjaftueshme faktin që krahas toponimisë sllave ekziston shpesh edhe një toponimi paralele shqipe e përdorur nga banorët. (Kostallari, 1965: 43). Është fakt i provuar dhe i pamohueshëm se në trevat shqiptare përdoren edhe toponime paralele shqipe, si p.sh. për *Zagori – Prapamali*, *Zadrime – Tejdrinë dhe Përtejdrinë*, *Zagorë – Pas Malit ose Mas Malit*, *Çorovodë – Uji i Zi* etj. **Në Prefekturën e Korçës:** *Bellovoda - Ujëbardhi; Bulgarec - Arbëri; Bradvica - Guracapi; Kamenica - Gurishtja; Gora – Diva, Doberçani – Shkrepaj, Podgorica – Temali; Në nënprefekturën e Kolonjës: *Borova – Pishaj, Vodica - Shënkolli; Zharkanji - Zazaka; Pepellashi -Lirza; Selenica e Pishës - Pyllasi.**

E keqja është se jo gjithnjë dhe jo me kohë është reaguuar në përmirësimin ose në emërtimin e drejtë. Me rëndësi është se pas çdo intervenimi në toponimi nevojitet të merret parasysh faktori i traditës, e cila si një komponentë konstante ka ndikuar që kombi dhe gjuha të mbesin edhe përpos shumë golgotave që ka kaluar populli ynë. Ky duhet të jetë edhe synim për riemërtimin e toponimeve e në veçanti ojkonimeve. Nëse për pushtetin shqiptar kjo është vështirë të realizohet, le të shikojë fqinjët maqedonas e mos flasim për ato grekë.

Toponimet më të shpeshta dygjuhësore shqip-sllavisht janë në **Kosovë** e në trevat shqiptare në Mal të Zi dhe Maqedoni. Kjo ndodh para së gjithash për shkak të infiltrimit të gjuhës së administratës dhe së dyti nga fakti se shqiptarët dhe sllavët gjatë shekujve kanë jetuar në rrethana historike të ngjashme, kanë pasur institucione shoqërore të ngjashme dhe ndoshta edhe njëfarë bashkekzistence (Ajeti, 1978: 351). Për herë të parë, përmes institucioneve shtetërore u bë e mundur që të “përmirësohen” disa emërtime vendbani-mesh ose të shkruhen në mënyrë paralele, si: Ferizaj – Uroshevac, Hani i Elezit - Gjeneral Janković, Fushë Kosovë - Kosovo Polje, Pejë – Peç – Ipek, Miradi – Dobrevë, Gjilan - Gnjilane etj. (Baliu, 2008: ).

Dekada me rradhë në **Maqedoni** janë zhvilluar procese përdhunuese ndaj gjuhës shqipe. Kjo ka qenë më e spikatur gjatë sistemit komunist, por një praktikë e tillë ka vazhduar deri në ditët e sotme. Pushteti dhe qarqe të caktuara vazhdimisht janë marrë me çështjen dhe procesin e slavizmit të dhunshëm të toponimisë shqiptare, duke sjellë ligje e dekrete nga organet e pushtetit maqedonas dhe duke sanksionuar ata që nuk ia janë përfillur këtë urdhri. E meta e këtyre ligjeve ka qenë se asnjëherë nuk janë mbështetur në natyrën e një gjuhe, traditës historike, dinjitetin kombëtar të një populli lidhur me toponimet që i përdor në gjuhën e vet. Andaj edhe këto përpjekje janë cilësuar si diskriminuese e poshtëruese që nuk mund të zbatohet asnjëherë jo vetëm këtu te ne, por edhe në çfarëdo vend tjetër të rruzullit tokësor.

Pra disa toponime në gjuhë të ndryshme kanë marrë trajta të veçanta dhe janë ngulitur kështu nga tradita e përdorimit popullor e letrar. Por ndonjëherë fryma shoviniste merr nëpër këmbë edhe logjikën më elementare. Kështu shqiptarët e Maqedonisë me dekada ishin të detyruar të përdorin toponimet sllave si kemi edhe **Bitolla, Skopje, Kiçevo, Debar, Resen, Ohrid** etj. në vend të trajtave shqipe **Manastir, Shkup, Kërçovë, Dibër, Resnjë, Ohër** etj. Puna shkante deri atje, sa që thuhej, p.sh. “Ju flet radio Kiçevo, Ji flet radio Skopje etj.

Kjo tendencë diskriminuese ka vazhduar deri në ditët e sotme. Të gjitha toponimet që gjatë qeverisjes serbe kanë marrë emra nga historia serbe dhe të cilët bullgarët gjatë luftës së Dytë Botërore i kanë riemërtuar sipas historisë së tyre, pas çlirimit ato janë riemërtuar me emra nga historia dhe kultura maqedonase Ta përmendim një lagje të Shkupit që shqiptarët e quajnë Hasanbeg, gjatë sundimit serb është emëruar si Singeliq, por pavarësisht të Maqedonisë kjo lagje merr emrin **Metodija Andonov Çento**. Riemërtime të tilla janë bërë edhe për shumë ojkonime, por vetëm nga kultura maqedonase. P.sh.: **Karaxhorxhevac** (serb.) > **Krumovo** (Bull.) > **Josifovo** (sipas heroit popullor Josif Josifoski – Sveshtarot (Maq.); **Aleksandrovo** (Serb.) > **Borisovo** (Bullg.) > **Milladinovci** (Maq.), **Kovaçevac** (Serb.) > **Ballabanovo** (Bullg.); **Petrovo** (Serb.) > **Mirçe Acev** (Maq.) ; **Dushanovac** (Serb.) > **Maxhari** (Maq.); **Olluiq** (Serb.) > **Kadriçakovo** (Maq.); Kjo gjë nuk ka ndodhur me lagjet dhe ojkonimet shqiptare.

### 3. Përfundim

Emrat e dyfishtë ose binjakë tregojnë fatin e Botës, Evropës dhe Ballkanit nëpër onomastikë. Dhe nëse kihet parasysh se, çdo gjuhë përveç që ka rregullat dhe normat e veta drejtshkrimore ka edhe traditën gjuhësore, andaj toponimet duhet të përdoren sipas atyre rregullave. Studimi dhe përdorimi i tyre mund të shërbejë si hyrje në studimin e përzjerjes së thellë, midis kulturave të tyre, nëpërmjet gjuhës, e jo ndalimi i tyre. Nëse lufta është vazhdim i politikës me mjete tjera, atëherë politika gjuhësore paraqet formën më të butë të luftës midis dy popujve.

Çdo kohë sjell një repertor të vetin të emrave, ashtu si çdo rajon në kuadër të gjuhës së vet ka vetitë dhe karakteristikat e veta Në toponimi ky thesar i pasur leksikor duhet të ruhet dhe mëkëmbet. Krijimtaria popullore me xhelozji i ruan dhe i kultivon dhe në një mënyrë të vetin i seleksionon duke i eliminuar dhe duke i mbajtur gjallë. Por meqë shumë toponime janë imponuar me anë të masave represive ose pushtuese, është koha që një pjesë të zëvendësohet me emra nga gurra popullore si shenja të identitetit të një populli.

### Bibliografia

- AJETI, Idriz (1978), *Kontribut për studimin e disa toponimeve të Malit të Zi*. Në “Kërkime gjuhësore”. Prishtinë.
- AZHEZH, Klod (1997), *Duçata na jazikot*, Skopje, Zumpres.
- BABIČ, Stjepan (1986), *Tvorba riječi u hrvatskom književnom jeziku*, JAZU, Globus. Zagreb.
- BALIU, Begzad (2006), *Demitizimi dhe standardizimi i onomastikës në Kosovë*. Prishtinë, Argeta – LMG.

- BALIU, Begzad (2008), *Onomastika e Kosovës (Ndërmjet miteve dhe identiteteve)*. Prishtinë: Era.
- GOSTL, Igor (1984), »Egzonimi«, *“Jezik 32”*: 78.88.
- ISMAJLI, Rexhep (1978), »Disa çështje të onomastikës shqiptare të mesjetës«: *“Studime Filologjike”*, nr. 4. .
- KALMETA, Ratimir (1985), »O imenima na našim zemljovidima«, *“Jezik 32”*: 88.90.
- KALVE, Luj Žan (1981), *Lingvistika i Kolonijalizam*. Beograd.
- KOSTALLARI, Androkli (1965), »Contribution a l’histoire des recherches onomastiques fans la domaine de l’albanais«. *“Studime albanologjike”*, nr. 1. Tiranë.
- LONČARIĆ, Mijo (1994), »Hrvatska imena država«, *“Jezik 42”*: 1.9
- MOSSÉ, F. *Equisse d’une histoire de la langue anglaise*
- MULAKU, Latif (1979), »Mbi disa toponime mesjetare shqipe të Kosovës«. Në *“Onomastika e Kosovës”*. Prishtinë.
- SHKURTAJ, Gjovalin (2001), *Onomastikë dhe etnolinguistikë*. Tiranë:Libri universitar. <http://www.hidra.hr/eurovoc/euv/EVIGN.HTM>.